

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	BioNTech mbyll tre fabrika në Gjermani - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/biontech-mbyll-tre-fabrika-ne-gjermani/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 16:48:29 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 16:43:49 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ac8c493df9592504e54b63c3d33cb0eeb21b6645923dccd98bf02ed532719ce0
TEKSTI	94ea630b1731ab904f7d1f0c6a8dcb6b260cf51fe2f120a6c0cd62a496836b07
PAMJA	24da492a99b20064e2fa4014704b85a8124e51adbc3431f33f5cf72839912bc8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9d9c49eeebd97de2c8b260173206f31ec5d96e7304edec0312eb9cc61d9e7bff
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	18c690da73dc1a573fdd24afdc5abc524a645e4949def315e2ee13951ef2125f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9d9c49eeebd97de2c8b260173206f31ec5d96e7304edec0312eb9cc61d9e7bff>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Elbasan Rusia Lufta në Iran SHBA Kuvendi i Kosovës

EVROPA

BioNTech mbyll tre fabrika në Gjermani

28 Shtator 2026 | 18:43

Gjigandi farmaceutik gjerman BioNTech, i cili u bë i njohur në të gjithë botën si kompania që zhvilloi vaksinën kundër koronavirusit, po planifikon të mbyllë tre nga fabrikat e tij në Gjermani , gjë që do të prekë 1,800 vende pune.

Kompania, me seli në Mainz, njoftoi sot se do të mbyllë njësitë e saj në qytetet Tübingen, Marburg dhe Indar-Oberstein, pasi nuk është gjetur asnjë blerës për t'i marrë ato.

Fabrika e Tübingen do të mbyllet në fund të vitit 2027, ajo e Marburgut në fillim të vitit 2028 dhe ajo e Indar-Oberstein në fund të vitit 2028.

BioNTech, së bashku me kompaninë amerikane Pfizer, ishte kompania e parë që mori miratimin për të shitur vaksinën kundër Covid-19, duke fituar miliarda dollarë.

Kompania u bë e famshme në botë, por kërkesa për vaksinat kundër Covid-19 ka rënë për disa vite dhe BioNTech nuk ka sjellë në treg asnjë produkt tjetër.

BioNTech shpjegon në njoftimin e saj se dështimi i saj për të shitur fabrikat e saj është kryesisht për shkak të tregut aktual të vështirë dhe klimës së investimeve.

Për të siguruar që mbyllja e objekteve të kryhet në një mënyrë shoqërisht të përgjegjshme, janë rënë dakord me këshillin e punës së kompanisë për kushte shtesë të shkurtimit të vendeve të punës, tha kompania në njoftim.

BioNTech, e cila punëson afërsisht 7,200 njerëz në të gjithë botën, ka kaluar nëpër një proces transformimi dhe ristrukturimi për disa vite. Hulumtimet janë duke u zhvilluar për një gamë të gjerë produktesh të reja, veçanërisht në fushën e onkologjisë.

Kompania po përqendrohet gjithashtu në imunoterapitë e bazuara në mRNA dhe përdorimin e kombinuar të antittrupave dhe ilaçeve. Qëllimi është të përdoren antittrupat për shpërndarje më të synuar të ilaçeve të kimioterapisë në qelizat cancerogjene.

E gjithë kjo kushton shumë para dhe BioNTech ka pësuar humbje të konsiderueshme. Në gjysmën e parë të këtij viti, rezultatet neto treguan një humbje prej 1.35 miliardë eurosh.

Përveç kësaj, drejtuesit kryesorë dhe themeluesit e kompanisë, Ugur Sahin dhe Ozlem Turecci, do të largohen nga kompania deri në fund të vitit dhe do t'i përkushtohen zhvillimit të gjeneratës së ardhshme të barnave të bazuara në mRNA në një kompani të re.

LAJMI I FUNDIT

18:41 Këshilli bashkiak i Belshit voton kundër bashkimit me Elbasanin

18:34 Qytetarët në gatishmëri për uraganin Polo në bregdetin e Meksikës në Paqësor

18:26 Messi shënon golin spektakolar nga goditja e dënimit, vetëm dy gola larg rekordit

18:21 SHPERNDARJE Greqi, hetimi zbulon burimin e shpërthimit vdekjeprurës në Athinë

18:08 Pas bisedës Vuçiç-Putin, Departamenti i Shtetit rikujton deklaratën e Rubios për çështjet problematike

18:01 Rritet prodhimi i çimentos, betonit dhe ilaçit, bien nafta dhe kromi

TESTIM

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

EVROPA

Greqi, hetimi zbulon burimin e shpërthimit vdekjeprurës në Athinë

Një hetim nga Drejtoria e Greqisë për Parandalimin e Zjarrvënieve (DAEE) ka zbuluar se një rrjedhje gazi natyror që shkaktoi një shpërthim vdekjeprurës në një...

18:21 | 28/09/2026

EVROPA

Vazhdojnë protestat! Spanjë, qytetarët kundër kostos së strehimit

Manifestuesit e vendosur në sheshin qendror të Madridit deklaruan të hënën se do të vazhdojnë presionin ndaj kryeministrit Pedro Sanchez për zbutjen e krizës së...

17:57 | 28/09/2026

EVROPA | LAJM KRYESOR | LAJMI I FUNDIT

BE miraton pesë projekte të përbashkëta të mbrojtjes për dronë, mbrojtje detare dhe raketore

Këshilli Evropian miratoi të hënën pesë Projektet e para të Mbrojtjes Evropiane me Interes të Përbashkët (EDPCI), me synim forcimin e gatishmërisë mbrojtëse dhe kapaciteteve...

17:21 | 28/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni

Punësimi

Follow Euronews on all platforms: